



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni vjeshtor**

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal**  
Mbledhja nr.43/2018  
Prishtinë, më 9.10.2018, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari - Lila, Muharrem Nitaj, Veton Berisha dhe Duda Balje, anëtarë.

**Munguan:** Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Glauk Konjufca, Liburn Aliu dhe Memli Krasniqi, anëtarë.

**Pjesëmarrës tjerë:** Artan Demolli, Valon Berisha dhe Gurakuq Kastrati, MTI; Dren Ajeti, Klubi i Prodhuesve Kosovarë; Besjana Bajrami- Ekonomia Online; Vatra Qehaja, GP/ LV; Shpresë Sejdiu, GP/ PSD; Sanie Jusufi- Koha ditore; Amire Qamili, Kallxo.com; Valmira Hoti, RTV21; Ismail Shabani - Kosovapress; Blenda Bejtullahu - EU office.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti, Veton Raci dhe Nurie Morina.

**Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 2 dhe 3.10.2018;
3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë për kandidatët për kryesues të Bordit të ZRRE-së;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente për Projektligjin nr. 06/L-033 për produkte të ndërtimit;
5. Të ndryshme.

*Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

## 1. Miratimi i rendit të ditës

**Mimoza Kusari - Lila**, kërkoi që të hiqet nga rendi i ditës, për këtë mbledhje, pika e tretë dhe të kërkohet nga Kryeministri sqarim: “Pse nuk është përfshirë në Propozim-vendimin e Qeverisë për kryesues të Bordit të ZRRE-së, kandidati me më së shumti pikë”? Sepse, Kryeministri, në letrën e dërguar nuk ka dhënë sqarim, ashtu siç kemi kërkuar.

**Dardan Sejdiu**, theksoi se në mbledhjen e kaluar kemi shfaqur brengën sesi kandidati, z. Fadil Ismajli, me më së shumti pikë, është hequr nga lista prej Qeverisë. Ndonëse pyetja është e qartë, përgjigja është komplet shpërfillëse ndaj kërkesave të deputetëve. Në përgjigjen e tij, Kryeministri thotë se Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2018, në pajtim me nenin 5 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ka proceduar dy kandidatë. Neni 5 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, paragrafi i dytë, fjalia e fundit thotë: “Qeveria, pas pranimit të dosjes së aplikantëve, ia dërgon Kuvendit së paku dy (2) kandidatë për një pozitë të lirë”. Dhe, ne po flasim vetëm edhe për një kandidat, i cili ka qenë me më së shumti pikë. Kërkoi që, derisa të kemi një përgjigje adekuate, konkrete, kjo pikë e rendit të ditës të hiqet nga shqyrtimi.

**Muharrem Nitaj**, tha se nëse dërgimi i emrave është në diskrecionin e Qeverisë, nëse është respektuar ligji, dhe nëse në ligj thuhet se Qeveria e Kosovës duhet të procedojë së paku dy emra, nuk e kuptoj pse përgjigja e Kryeministrit mund të jetë ofenduese. Nëse është respektuar ligji, ne ta procedojmë tutje, me këtë rend të ditës. Unë mendoj se në këtë rast nuk është shkelur ligji dhe ta procedojmë tutje.

**Kryetarja**, theksoi se Qeveria është bazuar në ligj. Në nenin 5 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, decidivisht ceket se Qeveria, pas pranimit të dosjes së aplikantëve, ia dërgon Kuvendit së paku dy (2) kandidatë për një pozitë të lirë. Kjo do të thotë se jemi në rregull me ligjin. Pse Qeveria nuk e ka propozuar emrin e caktuar, konsideroj se ajo është diçka shumë minore, krahasuar me nevojën për plotësimin e bordit.

**Hykmete Bajrami**, theksoi se Kryeministri i Kosovës, para pak ditës, ka bërë marrëveshje me kompaninë britanike për mbikëqyrjen e procesit të rekrutimit në pozita të larta. Qeveria ka hequr kandidatin me më së shumti pikë. Duhet të zgjedhën kandidatët që kanë më shumë pikë. Ndonëse pyetja është e qartë, përgjigja është shpërfillëse, të respektohet procesi i përzgjedhjes së kandidatëve.

**Veton Berisha**, theksoi se siç po shihet, është një kërkesë që të shtyhet kjo pikë, derisa të marrim një sqarim shtesë. T’i dërgohet kërkesë shtesë Qeverisë, që të sqarojë pse është hequr nga lista kandidati me më së shumti pikë. Qeveria mund të ketë ndonjë arsye, por ne nuk e dimë. Ndërsa, në javën e ardhme, ta trajtojmë këtë çështje.

*Pas debatit, komisioni vendosi që t’i dërgojë shkresë Kryeministrit, me kërkesën: Pse nuk është përfshirë edhe kandidati me më së shumti pikë, i propozuar nga Komisioni rekomandues „ad hoc”, për zhvillimin e procedurave të rekrutimit për kryesues të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.*

*Rendi i ditës u miratua me ndryshimin e propozuar nga deputetja Mimoza Kusari - Lila.*

## **2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 2 dhe 3.10.2018**

*Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 2 dhe 3.10.2018, u miratuan pa vërejtje.*

## **3. Shqyrtimi i raportit me amendamente për Projektligjin nr. 06/L-033 për produkte të ndërtimit**

**Kryetarja** falënderoi kryesuesen e grupit të punës, deputeten Mimoza Kusari - Lila, për punën e bërë në amendamentimin e Projektligjit për produkte të ndërtimit. Sot e kemi në shqyrtim, në komision, këtë raport me amendamente dhe ia dha fjalën kryesueses së grupit të punës, deputetes Mimoza Kusari - Lila.

**Mimoza Kusari - Lila**, theksoi se si grup i punës i kemi pasur disa takime me përfaqësues të ministrisë dhe tani kemi ardhur në pikën që konsiderojmë që Projektligji për produktet e ndërtimit i plotëson kushtet për procedim të mëtutjeshëm. Janë marrë parasysh amendamentet, janë sqaruar paqartësitë, të cilat kanë ekzistuar dhe konsiderojmë se projektligji është i domosdoshëm për një standard të mirëfilltë për prodhimin dhe importimin e produkteve të ndërtimit.

**Hykmete Bajrami**, theksoi se opinionin tim kundërshtues për këtë projektligj e kam dhënë. Unë kam theksuar se në departament, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, nuk ka kapacitete të tilla. Gjatë kohës sa kam qenë ministre, kam qenë tepër e pakënaqur me trupat e pavarura të autorizuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Ata, thjesht, shesin certifikata, ndërsa Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, asnjëherë dhe as sot, nuk ka kapacitete që t'i kontrollojë trupat e tilla. E njëjta gjë do të bëhet tash me produktet e ndërtimit. Pa pasur kapacitete shtetërore që të kontrollohen trupat private që punojnë në emër të shtetit, unë besoj që nuk duhet emëruar dhe autorizuar trupa të tilla. Unë jam tërhequr nga grupi i punës, sepse kam menduar që ligji duhet të kthehet dhe të hartohet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ku edhe është bartur një departament i tillë, në kohën sa ishte ministre, znj. Kusari. Jam kundër projektligjit dhe jo kundër amendamenteve. Kjo është arsyeja pse jam tërhequr nga grupi i punës.

**Mimoza Kusari - Lila**, propozoi që të gjitha amendamentet të votohen në pako, pasi që nuk ka diçka kontestuese.

*Propozimi i znj. Mimoza Kusari- Lila, që amendamentet të votohen në pako, u përkrah nga komisioni.*

*Pas debatit, komisioni, me 6 (gjashtë) vota “për” dhe 1 (një) “kundër”, nxori këtë:*

### *Përfundim*

*1. Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 06/L-033 për produkte të ndërtimit;*

*2. Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 06/L-033 për produkte të ndërtimit, procedohet në komisionet e përhershme për vlerësim, sipas kompetencës.*

*Këtij procesverbali i bashkëngjitet Raporti me amendamente.*

#### **4. Të ndryshme**

**Çështjet vijuese.**

**Mbledhja përfundoi në orën 12:00.**

**E përgatiti: Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetarja e komisionit,**

**Sala BERISHA SHALA**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni vjeshtor**

**Për: Komisionet e përhershme të Kuvendit të Republikës së Kosovës;**

Komisioni për Buxhet dhe Financa;

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim;

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit;

Komisioni për Integritet Evropian;

**Nga: Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal;**

**Lënda: Raporti me Amendamente i Projektligjit nr.06/L-033 për Produkte të Ndërtimit;**

**Datë: 9.10.2018, Prishtinë;**

---

Në bazë të nenit 57 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal, me datë 9.10.2018, e shqyrtoi dhe amendamentoit Projektligjin nr.06/L-033 për Produkte të Ndërtimit, dhe, procedon në Komisionet e përhershme për vlerësim sipas kompetencës, si në vijim:

**Amendamenti 1**

Neni 1, paragrafi 2, fjala “përmban” zëvendësohet me “përcakton”.

**Amendamenti 2**

Neni 1, i shtohet një paragraf i ri si në vijim:

3. Ky ligj është i bazuar në dispozitat përkatëse të Rregullores së Parlamentit Evropian Nr.305/2011/EU e cila përcakton kushtet për vendosjen në dispozicion të tregut të produkteve të ndërtimit.

**Amendamenti 3**

Neni 3, nënparagrafi 1.22, teksti “nga një vend i tretë” të zëvendësohet me “nga një vend i huaj”.

#### **Amendamenti 4**

Neni 5, paragrafi 1, teksti “standard i harmonizuar evropian” zëvendësohet me “standard i harmonizuar kosovar dhe evropian”.

#### **Amendamenti 5**

Neni 7, nënparagrafi 2.3 ndryshohet si në vijim:

2.3. Numrin e referencës dhe datën e lëshimit/publikimit të standardit të harmonizuar kosovar dhe evropian ose vlerësimit teknik evropian apo vlerësimit teknik të Kosovës që është përdorur për vlerësimin e çdo karakteristike themelore;

#### **Amendamenti 6**

Neni 7, nënparagrafi 3.6. shkurtesa dhe sqarimi “NPD” zëvendësohet me “NDP” (Nuk Deklarohet Performanca);”.

#### **Amendamenti 7**

Neni 9 paragrafi 1 ndryshohet si në vijim:

1. Për vendosjen e shenjës CE zbatohen parimet e përgjithshme të përcaktuara në rregullat specifike për shënjimin e konformitetit.

#### **Amendamenti 8**

Neni 9, paragrafi 4, “Rregulloren për Produktet e Ndërtimit Nr.305/2011/EU të Bashkimit Evropian” zëvendësohet me “Legjislacionin e Bashkimit Evropian për Produktet e Ndërtimit”

#### **Amendamenti 9**

Neni 12, paragrafi 1, referenca “dispozitat e Kapitullit IX të këtij ligji.” zëvendësohet me “dispozitat e nenit 55 të këtij ligji.”, dhe kjo vlen në tërë tekstin e projektligjit.

#### **Amendamenti 10**

Neni 13, paragrafi 4, riformulohet si në vijim:

4. Pika e kontaktit për produktet e ndërtimit në Kosovë, ku operatori ekonomik e ka tregtuar në mënyrë të ligjshme produktin e ndërtimit, duhet t’i ofrojë operatorit ekonomik ose autoritetit kompetent informatat relevante ose vrojtimitet.

#### **Amendamenti 11**

Neni 14, paragrafi 10, në pjesën e dytë, fshihet fjalia “Për më tepër,”, dhe kjo vlen në tërë tekstin e projektligjit.

## **Amendamenti 12**

Neni 15, paragrafi 4, fjala “themeluar” zëvendësohet me “regjistruar”.

## **Amendamenti 13**

Neni 17 paragrafi 5. fjalia ”ata duhet të ndërmarrin masa korrigjuese”, zëvendësohet me ” ata duhet të sigurohen që janë ndërmarrë masa korrigjuese”.

## **Amendamenti 14**

Neni 22, paragrafi 2, referenca ne nenet “40 deri 42” ndryshohet me “26, 27 dhe 28 të këtij ligji”.

## **Amendamenti 15**

Neni 23 paragrafi 2, referenca “Rregullores për Produktet e Ndërtimit Nr.305/2011/EU të Bashkimit Evropian” zëvendësohet me “Legjislacionin e Bashkimit Evropian për Produktet e Ndërtimit”.

## **Amendamenti 16**

Neni 24, ne paragrafin 1 dhe 4, referenca behët “nenin 50 të këtij ligji”.

## **Amendamenti 17**

Neni 25, paragrafi 2, referencës i shtohet teksti “të këtij ligji” dhe kjo vlen për tërë tekstin e projektligjit.

## **Amendamenti 18**

“Kapitulli VI” behët “Kapitulli V”.

## **Amendamenti 19**

Neni 30, paragrafi 2, fshihet fjalia ne kllapa “(por jo emërimi)”.

## **Amendamenti 20**

Neni 37, ndryshohet si në vijim;

1. Një trup për të qenë i emëruar që të kryejë detyra të palës së tretë në procesin e vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës, duhet të parashtron kërkesë për emërim tek autoriteti emërues i Kosovës.

2. Kërkesa duhet të shoqërohet me një përshkrim të aktiviteteve që do të kryhen, procedurat e vlerësimit dhe/ose të verifikimit për të cilat trup pretendon të jetë kompetent dhe certifikatën e akreditimit, të lëshuar nga organi kombëtar i akreditimit (DAK), që vërteton se trupi për vlerësimin e konformitetit i plotëson kërkesat e përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji.

### **Amendamenti 21**

Neni 38, fshihet paragrafi 4 dhe 5.

### **Amendamenti 22**

Neni 46, paragrafi 5,6,7, dhe 8, fjalia “Subjekti ekonomik” zëvendësohet me “Operator ekonomik”

### **Amendamenti 23**

Neni 47, paragrafi 1, pjesa e dytë e paragrafit riformulohet si në vijim “Në bazë të rezultateve të këtij vlerësimi, në mes të dy palëve arrihet marrëveshja edhe nëse masa është apo nuk është e justifikueshme.”.

### **Amendamenti 24**

Neni 54, riformulohet si në vijim:

1. Qeveria e Kosovës mund të kundërshtojë aktin e deleguar brenda një periudhe prej tre (3) muajsh nga data e njoftimit. Kjo periudhë mund të zgjatet edhe për tre (3) muaj, më me kërkesën e Qeverisë.

2. Nëse pas kalimit të periudhës së përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, Qeveria e Kosovës nuk e kundërshton aktin e deleguar, ai publikohet dhe hyn në fuqi në datën e përcaktuar në dokument. Akti i deleguar mund të publikohet dhe të hyjë në fuqi para kësaj periudhe, nëse Qeveria e Kosovës e informon Ministrinë që nuk do të ngrit kundërshtim.

### **Amendamenti 25**

Kapitulli IX, titullohet si në vijim “PRODUKTET E NDËRTIMIT QË NUK BARTIN SHENJËN E KONFORMITETIT”

### **Amendamenti 26**

Kapitulli X dhe neni 56, titullohen si në vijim:

KAPITULLI X DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 56 Shkeljet për vendosjen në treg të produkteve të ndërtimit

### **Amendamenti 27**

Neni 57, ndryshohen referencat si në vijim:



nënparagrafi 1.1. referenca “neni 13” behët “neni 14”;  
nënparagrafi 1.2. fshihet referenca “nënparagrafin 2.1.”;  
nënparagrafi 1.4. fshihet referenca “nënparagrafin 2.1”, si dhe “neni 16” duhet të behët “neni 17”;

### **Amendamenti 28**

Neni 58, ndryshohen referencat si në vijim:  
nënparagrafi 1.4., referenca “paragrafi 3” behët “paragrafi 4”;  
nënparagrafi 1.5., referenca “paragrafi 4” behët “paragrafi 5”;

### **Amendamenti 29**

Neni 60, riformulohet si në vijim:  
Më hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji nr. 04/L-181 për Produktet e Ndërtimit dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë të tij.

### **Amendamenti 30**

Neni 61, i shtohen dy paragraf si në vijim:  
5. Pa paragjykuar paragrafin 2 të nenit 37 të këtij ligji, që një trup të jetë i emëruar për të kryer detyra si palë e tretë nuk është i obliguar të paraqes certifikatën e akreditimit në aplikimin për në fushën për të cilën kërkon emërim për një periudhë prej dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.  
6. Në rastin e referuar në paragrafin 5 të këtij neni, kur trupa nuk mund të ofroj certifikatën e akreditimit, atëherë ai duhet t’i ofrojë autoritetit emërues të gjitha dëshmitë e dokumentuara të nevojshme për verifikim, njohje të kompetencës dhe monitorim të rregullt të përputhshmërisë së tij me kërkesat e përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji. Vendimi për emërim duhet të ketë afat të caktuar kohor jo më të gjatë se dy vite.

### **Amendamenti 31**

Neni 62, paragrafi 2, riformulohet si në vijim: “Nëse është e nevojshme, brenda dy viteve pas dorëzimit të raportit sipas paragrafit 1 të këtij neni në Qeverinë e Kosovës, ky raport duhet të plotësohet me propozimet legjislative adekuate.”

### **Amendamenti 32**

Neni 62, paragrafi 3, referenca “nenet 23 dhe 27” ndryshohet në “nenin 23 dhe 24 të këtij ligji”.

**Kryetarja e Komisionit,**

**Sala BERISHA SHALA**